

20141605000

**L I G J**  
**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR SIGURIM PENSIONAL DHE**  
**INVALIDOR**

Neni 1

Në Ligjin për sigurim pensional dhe invalidor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 98/12, 166/12, 15/13, 170/13, 43/14, 44/14, 97/14 dhe 113/14), pas nenit 117 shtohet Kapitull i ri X-a dhe dy nene të reja 117-a dhe 117-b, si vijojnë:

"Kapitulli X-a

**KËSHILLI PËR SIGURI SOCIALE**

Neni 117-a

(1) Për mbrojtje dhe promovim të të drejtave sociale dhe interesave të shfrytëzuesve të pensionit dhe ndërmarrje të masave për avancim të pozitës sociale dhe integrim dhe përmirësim të standardit jetësor të shfrytëzuesve të pensionit themelohet Këshilli për Siguri Sociale.

(2) Këshilli për Siguri Sociale:

1) i përcjell, studion dhe vlerëson ndikimin e masave të politikës ekonomike dhe sociale në pozitën sociale të shfrytëzuesve të pensionit;

2) i shqyrton efektet nga implementimi i ligjeve dhe projekteve për pensionistët dhe propozon masa dhe aktivitete për përmirësim të standardit të shfrytëzuesve të pensionit te Qeveria e Republikës së Maqedonisë;

3) jep mendim për propozime të ligjeve nga sfera e sigurisë sociale dhe mbrojtjes sociale dhe

4) jep mendime dhe propozime ministrit për Punë dhe Politikë Sociale në lidhje me çështje të përcaktuara me këtë ligj.

(3) Këshilli për Siguri Sociale miraton rregullore me të cilën rregullohet mënyra e punës së Këshillit.

Neni 117-b

(1) Anëtarët e Këshillit për Siguri Sociale i emëron ministri i Punës dhe Politikës Sociale për kohë prej katër vitesh, edhe atë:

- tre anëtarë emërohen me propozim të Lidhjes të Shoqatave të Pensionistëve të Maqedonisë;
- një anëtar emërohet me propozim të Kabinetit të zëvendëskryeministrit të Qeverisë, i obliguar për çështje ekonomike dhe për koordinim të resorëve ekonomikë;
- një anëtar emërohet me propozim të Ministrit të Punës dhe Politikës Sociale;
- një anëtar emërohet me propozim të Ministrisë së Financave;
- një anëtar emërohet me propozim të Ministrisë së Ekonomisë;
- një anëtar emërohet me propozim të Ministrisë së Shëndetësisë;
- një anëtar emërohet me propozim të Fondit për Sigurim Pensional dhe Invalidor të Maqedonisë;
- një anëtar emërohet me propozim të Fondit për Sigurim Shëndetësor të Maqedonisë;
- një anëtar emërohet nga Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë;
- një anëtar emërohet nga Agjencia për Supervizion të Sigurimit Pensional me Financim Kapital dhe
- nga një anëtar emërohet nga shoqëritë për menaxhim me fondet pensionale të detyrueshme dhe/ose vullnetare.

(3) Këshilli për siguri sociale nga anëtarët zgjedh kryetar dhe zëvendëskryetar në kohë prej një viti.

#### Neni 2

Në nenin 127 paragrafi (1) pas fjalës “sigurim” shtohen fjalët: “në formë me shkrim”, ndërsa pika në fund të fjalisë shlyhet dhe shtohen fjalët: “ose nëpërmjet qasjes elektronike në ueb faqen e Fondit”.

#### Neni 3

Në nenin 157 paragrafi (1) në pikën 7) fjalët: “vendos për” zëvendësohen me fjalën: “proponon”.

Pika 8) ndryshohet si vijon:

8) "dorëzon propozim te Qeveria e Republikës së Maqedonisë për shitje të pronës së dhënë në shfrytëzim të përhershëm të Fondit”.

#### Neni 4

Në nenin 187 paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

“Shitja dhe dhënia me qira e pronës në pronësi ose shfrytëzim të përhershëm të Fondit do të bëhet sipas dispozitave të Ligjit për shitje dhe dhënie me qira të ndërtesave afariste dhe lokaleve afariste të Republikës së Maqedonisë”.

#### Neni 5

(1) Dispozitat e nenit 37 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji nuk zbatohen në periudhën prej 1 janar deri më 31 dhjetor të vitit 2015.

(2) Në vitin 2015 të gjitha llojet e pensioneve në pajtim me këtë ligj harmonizohen në mënyrë që shumta e përgjithshme e pagesës së pensioneve për shtator të vitit 2015 zmadhohet për 5% dhe pjesëtohet me numrin e përgjithshëm të shfrytëzuesve të pensioni të cilët pensionin e kanë realizuar përfundimisht me shtator të vitit 2015.

#### Neni 6

Autorizohet Komisioni Juridik Ligjvënës i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë që të përcaktojë tekst të spastruar të Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor.

#### Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”, ndërsa dispozitat e neneve 2 dhe 5 paragrafi (2) të këtij ligji do të fillojnë të zbatohen nga 1 tetori 2015.